



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, me \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

**Shtojca 12**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

28.10.2021

Drejtuar: “START CO” SHPK, me adrese: Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1, Tirane

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur/Mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-07929-10-12-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Automjeti te ri Zjarrefikes per nevoja te Bashkise Lezhe”

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “ALMETA GMBH” SH.P.K, me Nuis K22013001U, me oferte ekonomike 9,945,500 (nente million e nenteqind e dyzet e pese mije e peseqind) Lek pa TVSH
- 2- Operatori Ekonomik “MUHOPLUS LTD” SH.P.K, me Nuis L52317046G, me oferte ekonomike 9,960,500 (nente milion e nenteqind e gjashtedhete mije e peseqind) Lek pa TVSH.
- 3- Operatori Ekonomik “START CO” SH.P.K, me Nuis L11614001S, me oferte ekonomike 9,875,500 (nentemilion e teteqind e shtatedhete e pesemije e peseqind) Lek pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1- Operatori Ekonomik “ALMETA GMBH” SH.P.K, me Nuis K22013001U, per arsyet e meposhtme:

Nga verifikimi ne SPE rezulton se:

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 1.b te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se:  
*1.Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Komisioni i Vleresimit te Ofertave bazuar ne nenin 83 te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se:

*1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.*

*Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:*

*i. në formën e garancisë bankare; ose*

*ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente, nenin 30 te te VKM-se 285 date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se:*

*“1Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.*

*Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.*

*Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

*2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”, vlereson se per te permbushur kete kriter OE-te duhet te paraqesin sigurimin e ofertës ne formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi.Nga verifikimi ne SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur formularin e sigurimit te ofertes.*

**Se dyti**, nuk ploteson kriterin 2.3.2 te DST-se ne te cilin kerkohe:

*Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:*

*- Licence e lëshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi VII.3.B.2 “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi”, sipas Udhezimit te Ministrise se Trasnsportit dhe Infrastruktures Nr. 1545, dt. 29/03/2016, pasi nga verifikimi i ne SPE, rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe deshmon disponimin e Licences VII.3.B.2, duke mos permbushur kete kriter.*

**Se treti**, nuk ploteson kriterin 2.3.4 te DST-se ne te cilin kerkohe: *Ofertuesi duhte te paraqese Deklarate per modelin, kompanine prodhuese, vendin e prodhimit per mjetin objekt furnizimi*, pasi nga verifikimi ne SPE rezulton operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per permbushjen e ketij kriteri.

**Se katerti**, nuk ploteson kriterin 2.3.5 te DST-se ne te cilin kerkohe: *Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributori te autorizuar. Ne rastin e autorizimit te distributorit te autorizuar duhet te bashkangjitet marreveshja ku verifikohet lidhja e distributorit me prodhuesin. Autorizimi duhet te permbaj adresat, numrat e telefonit si dhe email nese do jene te nevojshme per tu verifikuar*, pasi nga verifikimi i ne SPE, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur nje dokument me shenimin “Autorizim prodhuesi”, i cili rezulton ne gjuhe te huaj (anglisht), i paperkthyer ne gjuhen shqipe.

KVO veren se ne piken 2 te nenit 24, te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. **Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.** Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Sa me siper dokumentacioni i paraqitur nga OE per plotesimin kriteri 2.3.5 nuk eshte ne perputhje me piken 2 te nenit 24, te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke mos permbushur kete kriter.

**Se pesti**, nuk ploteson kriterin 2.3.6 te DST-se ne te cilin kerkohe: *Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog/fragment katalogu/ skede teknike, ku të pasqyrohen të dhënat e mjetit, modeli, viti i prodhimit i tij si edhe cdo e dhenë tjetër teknike e mjetit te ofruar*, pasi nga verifikimi i ne SPE, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur nje dokument me shenimin “Katalog”, i cili rezulton ne gjuhe te huaj (anglisht), i paperkthyer ne gjuhen shqipe.

KVO veren se ne piken 2 te nenit 24, te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. **Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.** Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Sa me siper dokumentacioni i paraqitur nga OE per plotesimin kriteri 2.3.6 nuk eshte ne perputhje me piken 2 te nenit 24, te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke mos permbushur kete kriter.

**Se gjashti**, nuk ploteson kriterin 2.3.7 te DST-se ne te cilin kerkohe: *Operatori duhet te paraqese nje deklarate garancie per nje periudhe 1 vjecare per defektet te paparashikuara per mjetin ne te cilen te jete te percaktuar qarte te gjitha kushtet e garancise teknike te mjetit (kjo pike plotesohet me paraqitjen e vetedeklarimit te kandidatit ofertues)*, pasi nga verifikimi ne SPE rezulton operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per permbushjen e ketij kriteri.

*Se shtati*, nuk ploteson kriterin 2.3.8 te DST-se ne te cilin kerkohet: *Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër te furnizoje/transportoje dhe te dorezoje mallin objekt kontrate, ne vendet e percaktuara nga ana e Bashkisë Lezhe me mjetet e tij qe ka ne dispozicion sipas kerkeses se AK. (Deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise), brenda afatit te levrimit, pasi nga verifikimi ne SPE rezulton operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per permbushjen e ketij kriteri*

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “ALMETA GMBH” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ALMETA GMBH” SH.P.K, me Nuis K22013001U, skualifikohet.**

2- Operatori Ekonomik “MUHOPLUS LTD” SH.P.K, me Nuis L52317046G, per arsyet e meposhteme:

Nga verifikimi ne SPE rezulton se:

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 1.b te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se:

*1. Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Komisioni i Vleresimit te Ofertave bazuar ne nenin 83 te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se:

*1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të*

*kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.*

*Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:*

*i. në formën e garancisë bankare; ose*

*ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente, nenin 30 të VKM-se 285 date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se:*

*“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.*

*Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.*

*Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

*2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”, vlereson se për të përmbushur këto kriter OE-te duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi. Nga verifikimi në SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertes.*

**Se dyti**, nuk ploteson kriterin 2.3.2 të DST-se në të cilin kerkohet:

*Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:*

*- Licence e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi VII.3.B.2 “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi”, sipas Udhezimit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturas Nr. 1545, dt. 29/03/2016, pasi nga verifikimi i në SPE, rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që deshmon disponimin e Licences VII.3.B.2, duke mos përmbushur këto kriter.*

**Se treti**, nuk ploteson kriterin 2.3.4 të DST-se në të cilin kerkohet: *Ofertuesi duhte të paraqese Deklarate për modelin, kompaninë prodhuese, vendin e prodhimit për mjetin objekt furnizimi, pasi nga verifikimi në SPE rezulton operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e këtij kriteri.*

**Se katerti**, nuk ploteson kriterin 2.3.5 të DST-se në të cilin kerkohet: *Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar. Në rastin e autorizimit të distributorit*

*te autorizuar duhet te bashkangjitet marreveshja ku verifikohet lidhja e distributorit me prodhuesin. Autorizimi duhet te permbaj adresat, numrat e telefonit si dhe email nese do jene te nevojshme per tu verifikuar, pasi nga verifikimi i ne SPE, rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe deshmon disponimin e autorizimit te prodhuesit ose distributorit te autorizuar , duke mos permbushur kete kriter.*

***Se pesti***, nuk ploteson kriterin 2.3.6 te DST-se ne te cilin kerkohet: *Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog/fragment katalogu/ skede teknike, ku të pasqyrohen të dhënat e mjetit, modeli, viti i prodhimit i tij si edhe cdo e dhenë tjetër teknike e mjetit te ofruar , pasi nga verifikimi i ne SPE, rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne lidhje me katalog/fragment katalogu/ skede teknike, duke mos permbushur kete kriter.*

***Se gjashti***, nuk ploteson kriterin 2.3.7 te DST-se ne te cilin kerkohet: *Operatori duhet te paraqese nje deklarate garancie per nje periudhe 1 vjecare per defektet te paparashikuara per mjetin ne te cilen te jete te percaktuar qarte te gjitha kushtet e garancise teknike te mjetit (kjo pike plotesohet me paraqitjen e vetedeklarimit te kandidatit ofertues), pasi nga verifikimi ne SPE rezulton operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per permbushjen e ketij kriteri.*

***Se shtati***, nuk ploteson kriterin 2.3.8 te DST-se ne te cilin kerkohet: *Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizoje/transportoje dhe të dorëzoje mallin objekt kontrate, ne vendet e percaktuara nga ana e Bashkisë Lezhe me mjetet e tij qe ka ne dispozicion sipas kerkeses se AK. (Deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise), brenda afatit te levrimit, pasi nga verifikimi ne SPE rezulton operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar per permbushjen e ketij kriteri*

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët

ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e **OE “MUHOPLUS LTD” SH.P.K.**, për mos përmbushje të kritereve të vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “MUHOPLUS LTD” SH.P.K, me Nuis L52317046G, skualifikohet.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “START CO” SHPK, me adresë: Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 9,875,500 (nëntemilion e teteqind e shtatedhjetë e pesemijë e peseqind) Lek pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**